E hënë, 22 prill 2024

[Seancë e hapur]

[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

--- Seanca fillon në orën 09.00

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën. Më falni, Sekretar i Gjykatës.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ju faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Vërej që të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm fizikisht në sallën e gjyqit.

Përpara se të vijojmë me dëshminë e Dëshmitarit W04739, duhet të trajtojmë disa aspekte paraprake.

Fillimisht, sa i takon incizimeve audio-video të deklaratave të disa dëshmitarëve, Trupi Gjykues vëren se në përputhje me rregullën e katërt të Trupit Gjykues që mban datën 13 janar 2024, ZPS-ja ka dorëzuar përmes dokumentit 02129 incizimet audio-video të deklaratave të dëshmitarit që janë pranuar më herët nga Trupi Gjykues në bazë të rregullës 143(2) dhe 155.

Pasi konstatuam se deklaratat janë të pranueshme në bazë të rregullës 143(2)(c) dhe 155, Trupi Gjykues pranon në prova

gjyqësore edhe incizimet audio-video përkatëse të deklaratave të evidentuara në Shtojcën 1 të dokumentit 02129 dhe udhëzon Zyrën Administrative audio-video të njëjtat numra të provës materiale që ju janë dhënë deklaratave që tashmë janë pranuar në provat gjyqësore dhe që lidhen me incizimet audio-video dhe kjo është evidentuar në Shtojcën 1 të dokumentit 02129.

Sa i takon klasifikimit, Trupi Gjykues merr parasysh se në bazë të urdhrit me gojë të 2 prill 2024 të Trupi Gjykues, ZPS-ja ka bërë me dije në parashtrimin e protokolluar 02223 se klasifikimi i propozuar për incizimet audio-video që sapo u pranua në bazë të rregullës 143(2)(c) dhe 155 dhe incizimet audio-video të deklaratave të dëshmitarëve të rregullës 153, që janë pranuar nga Trupi Gjykues më 2 prill 2024. Mbrojtja nuk ju kundërpërgjigj parashtrimeve të ZPS-së.

Pasi rishikuam klasifikimet e propozuara të incizimeve audio-video të pranuara, Trupi Gjykues udhëzon Zyrën Administrative që t'u caktojë incizimeve audio-video sipas rregullës 143(2) dhe 155 klasifikimin që është përcaktuar në Shtojcën 1 të parashtrimit të protokolluar 02223 dhe të riklasifikojë provat materiale 00825.1 dhe 00825.2, që aktualisht janë të klasifikuara si konfidenciale të riklasifikohen, pra, si publike dhe, gjithashtu, t'u japë incizimeve audio-video sipas rregullës 153 të njëjtin klasifikim që është në Shtojcën 2 të parashtrimit të protokolluar në 0223.

Tani duhet të kalojmë në seancë private për të diskutuat pak kërkesën për pranimin e dokumenteve që janë përdorur gjatë dëshmisë së Dëshmitarit 04739, me përjashtim të rasteve, në qoftë se ka ndonjë gjë që duhet diskutuat në seancë publike?

Z. ROBERTS: [Përkthim] Po. Do kërkoja të shtyhej pak afati për t'ju kundërpërgjigjur parashtrimit të Prokurorisë sepse u konsultova me Prokurorinë paradite, nuk kanë asnjë kundërshtim. Është kundërpërgjigja për dokumentin F2248 që është kërkesë për pranimin e dokumenteve nga mocionet jo gojore që lidhen me zonën e Drenicës, kemi kërkuar një javë shtesë në qoftë se është e mundur, Prokuroria tha që nuk ka asnjë kundërshtim. Pra, do të doja që afatin ta shtynim nga 29 prill në 6 maj.

Z. HALLING: [Përkthim] E konfirmoj.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kërkesa miratohet. Mund të merrni kohë shtesë në datën që kërkuat. Dhe kjo do të jetë dhe data për afatin e fundit për t'ju kundërpërgjigjur parashtrimit të Prokurorisë.

Ju lutem tani të kalojmë në seancë private.

[Seancë e mbyllur]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson dhe sa kohë ju nevojitet?

Z. EMMERSON: [Përkthim] Besoj se do të përfundoj para seancës së paradites.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Bëjmë dhjetë minuta pushim.

--- Seanca ndërpritet në orën 10.01

--- Seanca rifillon në orën 10.12

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në seancë të mbyllur, ju lutem.

[Seancë e mbyllur]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kemi kaluar në seancë publike.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk ju kam treguar sesa kohë do të bëjmë pyetjet e mia, i nderuar Gjykatës, por besoj se rreth një orë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Marrim pushim deri në orën 11.30.

--- Pauza fillon në orën 10.59

--- Seanca rifillon në orën 11.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në seancë të mbyllur.

[Seancë e mbyllur]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike. Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rifillojmë në orën 2.30.

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.02

--- Seanca rifillon në orën 14.30

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni, ju lutem.

Znj. Alagendra, a mund t'ju pyes, edhe sa kohë ju duhet?

ZNJ. ALAGENDRA: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jo më shumë se 20 minuta.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe z. Misetic, vazhdoni të mos keni pyetje?

Z. MISETIC: [Përkthim] Unë në fakt kam nja 10 minuta.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord.

Ne pyesim për të -- për t'i treguar dëshmitarit tjetër nëse do të jetë -- të fillojmë sot. Besoj se e kemi mundësinë ta fillojmë, të paktën pjesërisht.

Kalojmë në seancë të mbyllur, ju lutem.

[Seancë e mbyllur]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kemi hyrë në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pushim deri në orën 15.10.

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Të gjithë në këmbë.

--- Pauza fillon në orën 15.00

--- Seanca rifillon në orën 15.10

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni ju lutem.

Z. Emmerson, u për -- e morët përgjigjen që kishit nevojë?

Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk m'u përgjigj kush por do të ndjek procesin e zakonshëm dhe do të diskutojmë me Prokuroren kur të bëhet ndërrimi i Prokurorëve.

Z. HALLING: [Përkthim] Unë ndërkohë e kam informuar Prokurorin përkatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

[Seancë e mbyllur]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e mbyllur tekst fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Bëjmë vetëm pak minuta pushim deri sa të organizohet Prokuroria.

Z. HALLING: [Përkthim] Ju lutem 5 ose 10 minuta sa të organizohemi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i them Sekretarit të na njoftojë kur të jemi gati të rifillojmë. Faleminderit.

--- Pauza filloi në orën 15.26

--- Seanca rifillon në orën 15.36

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Uluni ju lutem.

Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të kalojmë për një çast në seancë private?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar] Tani do të fillojmë të dëgjomë Dëshmitarin e Prokurorisë

4741.

Zonja Asistente, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Ndërkohë që bëhet një gjë e tillë, a mund të përmend që unë do të isha i pari nga ekipet Mbrojtëse. Thjesht doja të njoftoja Trupin Gjykues për këtë çështje.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Prokurore, sa kohë mendoni se do t'ju duhet?

ZNJ D'ASCOLI: [Përkthim] Dy orë do të mbetemi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë mund --

Z. ROBERTS: [Përkthim] Unë do të kërkoja më shumë se një orë e gjysmë që kisha parashikuar. Do të thosha më shumë se dy orë.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Nëse ju ndihmon, unë do të shfrytëzoj shumë më pak se sa tre orë që kisha vlerësuar më parë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Z. MISETIC: [Përkthim] Unë do të respektoj atë orar që kam parashikuar.

Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk kemi ndryshime. Do t'ju përditësojmë në qoftë se ndryshojmë mendimin tonë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëdita,

dëshmitar.

Asistentja do t'ju japë deklaratën -- betimin solemn, të cilin do të duhet ta bëni në bazë të Rregullës sonë 141(2). Ju lutem lexojeni me zë të lartë.

DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësisë sime ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

DËSHMITARI: RAMIZ QERIQI

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Mund të uleni.

Dëshmitar, sot do të fillojmë dëshminë tuaj, e cila pritet që të zgjasë rreth dy ditë. Siç e dini, Prokuroria do t'ju bëjë pyetje së pari. Pasi të ketë përfunduar, ka të drejtën pala Mbrojtëse t'u bëjë pyetje. Anëtarët e Trupit Gjykues mund të bëjnë po kështu pyetje.

Prokuroria ka vlerësuar se do t'i duhet 2 orë për t'ju bërë pyetje, ndërsa pala Mbrojtëse mendon afërsisht tetë orë t'ju bëjë pyetje. Për sa i përket këtij vlerësimi, ne shpresojmë që ekipet e avokatëve të mund ta shfrytëzojnë kohën në mënyrën e duhur. Trupi Gjykues mund të lejojë edhe marrje në pyetje të më pastajme, nëse janë përmbushur kushtet.

Ju lutem përgjigjuni pyetjeve qartë dhe me fjali të shkurtra. Në qoftë se nuk e kuptoni një pyetje, i kërkoni avokatit që ta përsërisë, apo thoni që nuk e keni kuptuar, dhe

ata do të përpiqen që ta sqarojnë pyetjen që bëjnë.

Po kështu tregoni se mbi ç'bazë i keni -- dhe cilën -- mbi të cilat rrethana i jepni përgjigje pyetjeve tuaja.

Në qoftë se ZPS-ja ju kërkon që të bëni korrigjime në lidhje me deklaratat tuaja, do të duhet të konfirmoni nën betim që dëshmia e korrigjuar reflekton në mënyrë të qartë mendimet tuaja.

Ju lu -- gjithashtu flisni në mikrofon dhe prisni pesë sekonda përpara se të jepni përgjigje pyetjes dhe flisni ngadalë në mënyrë që përkthyesi të mund ta përballojë shpejtësinë.

Gjatë ditëve në vazhdim, ndërkohë që jepni dëshmi në këtë sallë gjyqi, nuk jeni i lejuar që ta diskutoni përmbajtjen e dëshmisë suaj me askënd jashtë kësaj salle. Në qoftë se një person jashtë kësaj salle ju pyet lidhur me dëshminë tuaj, na tregoni menjëherë.

Ndaloni së foluri në qoftë se ju kërkoj unë. Ndaloni po kështu në qoftë se më shihni që ngre dorën. Këto tregojnë që unë do t'u jap një udhëzim juve.

Në qoftë se keni nevojë për të marrë pushime, ju lutem na tregoni dhe do të përpiqemi që të -- që ta realizojmë.

Fillojmë me pyetjet nga pala -- nga pala e Prokurorisë që janë në të majtën tuaj

Znj. Prokurore, ju e keni fjalën. Mund të filloni.

ZNJ D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

Gjykatës.

Pyetje nga znj. D'Ascoli:

PY. Mirëdita, Dëshmitar.
PË. Mirëdita.
PY. Jemi takuar javën e shkuar.
PË. Po.
PY. Unë jam Silvia D'Ascoli, jam Prokurore me Zyrën e Prokurorit të Specializuar, dhe do t'ju bëj pyetje gjatë ditës së sotme.
Kryegjykatësi ju ka dhënë disa udhëzime specifike lidhur me dëshminë tuaj. Ju lutem që t'i zbatoni në mënyrë të veçantë që të lejoni një pushim midis pyetjeve dhe përgjigjeve. Nga seanca përgatitore që kemi mbajtur unë kam kuptuar se ti kupton ca anglisht, kështu që do të duhet që të prisni deri sa të përfundojë përkthimi që dëgjoni me dëgjueset tuaja. Pra ne duam që ti t'i kuptosh në mënyrë të saktë pyetjet që të bëhen.
PË. Faleminderit. Vetëm disa terme, se s'e kuptoj anglishten.
PY. Do ta merrni përkthimin në gjuhën shqipe.
Dëshmitar, a mund të tregoni këtu emrin dhe mbiemrin e plotë?
PË. Ramiz Qeriqi.
PY. Datëlindja.
PË. 15 prill, 1962.
PY. Vendlindja.
PË. Krojmir.

PY. Cila është kombësia juaj?
PË. Shqiptar.
PY. A keni pasur ndonjë nofkë apo pseudonim?
PË. Gjatë luftës, edhe para luftës, nofkën Luani.
PY. Dëshmitar, në të shkuarën na keni -- keni dhënë një deklaratë edhe për zyrën tonë. Keni pasur mundësi që ta rishikoni këtë deklaratë gjatë javës së shkuar, gjatë përgatitjes për dhënien e dëshmisë së ditës së sotme.

ZNJ D'ASCOLI: [Përkthim] Dhe tani në ekran do të vendos këto deklarata, të cilat Zyra e Prokurorit të Specializuar kërkon që të pranohen si prova materiale. Ju lutem që t’i shikoni në ekran.

Deklarata e parë që duhet të vendoset në ekran ka numrin rendor ERN IT-03-66 T351 [Sipas përkthimit] deri T3630. Ju lutem që të vendosim faqen e parë në ekran.

PY. Dëshmitar, së shpejti do të shihni që të shfaqet dokumenti në ekran por nuk është shfaqur ende. A e shini faqen e parë të këtij transkriptimi në ekran.
PË. Po, është anglisht.
PY. Po. Rreshti numër 1 ka datën 28 shkurt të vitit 2005. Ne e kemi edhe transkriptimin e së njëjtës deklaratë në gjuhën shqipe, por kjo bëhet -- tani në këtë çast bëhet thjeshtë për identifikim. A të kujtohet që t’i kesh dhënë dëshmi TPNJ-së, Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë në vitin 2005, pra në çështje penale Limaj?

PË. Po.

PY. Dita e parë e dëshmisë suaj ishte kjo ditë, 28 shkurti i vitit 2005.

ZNJ D'ASCOLI: [Përkthim] A mund të kalojmë tani në faqen 2 të këtij transkriptimi.

PY. Dëshmitar, në rreshtin 3 a sheh emrin tënd?

PË. Po.

PY. Dëshmia juaj në TPNJ ka zgjatur tre ditë. Dita 28 shkurt është dita e parë dhe më pas janë dy ditët në vazhdim. Këto janë tre ditë të cilat i korrespondojnë tre transkriptimeve të ndryshme dhe numrat rendorë të këtyre transkriptimeve do t'i paraqes për pranim më vonë.

Dëshmitar, ne i rishikuam këto transkriptime gjatë javës së shkuar, ndërkohë që përgatiteshim për dëshminë tuaj sot, apo jo?

PË. Po.

PY. Pra, ky është transkriptimi i parë të cilin do të kërkoj që ta paraqesim si provë materiale. I dyti është intervista që i ke dhënë ZPS-së në vitin 2019.

ZNJ D'ASCOLI: [Përkthim] A ka mundësi që të shfaqim në ekran ERN083272-TR-ET, Pjesa 1 RED. Edhe në këtë rast bëhet fjalë për transkriptimin në anglisht, ne mund të vendosim edhe atë në variantin shqip nëse është më lehtë. Ka të njëjtin numër të provës, vetëm se në fund ka shkronjat AT.

PY. Dëshmitar, a e shikon transkriptimin në anglisht, e sheh

emrin tënd në rreshtin 17? Kjo është pjesa e parë e deklaratës --
PË. Po.
PY. -- tënde me ZPS-në.
PË. Po.
PY. Kjo intervistë ka dhjetë pjesë. Dëshmitar, a të kujtohet që e kemi rishikuar të gjithë transkriptimin e kësaj intervistën javën e shkuar, ndërkohë që përgatiteshim për dëshminë e ditës së sotme?
PË. Po.
PY. Gjatë rileximit të këtyre deklaratave javën e shkuar, a ju dha mundësia që të bënit disa korrigjime dhe sqarime për këto deklarata?
PË. Po, s'ishin të mëdha, ishin shumë të vogla. Po.
PY. Dhe këto korrigjime dhe sqarime a janë pasqyruar në një shënim me shkrim, i cili ju së lexuar me zë të lartë në përfundim të seancës së përgatitjes të premten e shkuar, më 19 prill të vitit 2024? Këtë shënim mund ta vendosim në ekran pasi të na jepni përgjigjen.
PË. Po.
ZNJ D'ASCOLI: [Përkthim] Atëherë, Sekretarja, a mund të vendosim Shënimin Përgatitor 1, ERN120550 deri në 120558.
PY. Dëshmitar, a e mban mend që ky shënim të është lexuar me zë të lartë në përfundim të seancës përgatitore të premten e shkuar?

PË. Po.

PY. A konfirmoni se ajo që është shënuar në këtë shënim pasqyron në mënyrë të saktë të gjitha korrigjimet dhe sqarimet, të gjitha këto që të janë lexuar nga ky shënim me zë të lartë, domethënë?

PË. Po, këtu është vetëm anglisht, por e di që atë ditë kanë qenë shumë [E pakuptueshme] në rregull. Krejt ka qenë në rregull. Po.

PY. Me përjashtim të korrigjimeve dhe sqarimeve, deklaratat tuaja me shkrim, ato që i kemi shikuar, a pasqyrojnë në mënyrë të saktë ato që thatë atëherë dhe ato që do thoshit sot nëse do të t'u bëheshin këtu në sallë të njëjtat pyetje?

PË. Ashtu, s'kam çka të ndryshoj asgjë. Ashtu do të jetë qysh e kam thënë më herët, dhe tash.

ZNJ D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, tani që kemi përmbushur kriteret e Rregullës 154 dhe në përputhje me vendimin 0244, ZPS-ja e paraqet variantet në anglisht dhe në shqipe të deklaratave të Rregullës 154 siç -- para -- se bashku me provat materiale shoqëruese dhe me shënimit përgatitor, si prova materiale dhe do t'i lexoj numrat -- numrat tani në vazhdim, duke specifikuar edhe çfarë klasifikimi do të kenë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

ZNJ D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

Deklarata e parë është dëshmia e TPNJ-së e 28 shkurtit të

vitit 2005, deri më datën 3 mars të vitit 2005. Pjesa e për -- e datës 28 shtator [Sipas përkthimit] është ERN IT-03-66 T351 [Sipas përkthimit] deri në T3630. E dyta e 2 marsit ka shifrën IT-03-66 T36 [Sipas përkthimit] deri në T3655 [Sipas përkthimit], e paredaktuar. E pjesa e tretë e datës 3 mars ka shifrën ERN IT-03-66, 3686 deri në T3760.

Dhe sa për sqarim, vetëm faqet 3686 deri në 3718 të pjesës së tretë janë ato që kërkojmë që të pranohen si prova materiale -- si prova materiale, pasi vetëm nga kjo tre -- faqe 3719 është dëshmi e një dëshmitari tjetër.

Dhe po kështu kërkojmë që të pranohen edhe përkthimet në shqipe të këtyre tre pjesëve.

Nëse dëshironi që të tregoj edhe pjesët në gjuhën shqipe të 3 marsit të vitit 2005 mund ta bëj një gjë të tillë. 03-03, pjesa 2/IT [Sipas përkthimit]. Faqet të cilat paraqet prova materiale janë faqet 1 deri në 5. Nga faqja 6 fillon dëshmia e një dëshmitari tjetër.

Për sa përket klasifikimit, këto deklarata duhet të mbeten konfidenciale për shkak se kanë disa pjesë të dhëna në seancë private.

Deklarata e dytë, intervista me ZPS-në, 372 [Sipas përkthimit], Pjesët 1 deri në 10 RED dhe transkriptimet në shqipe. Pjesa 1 deri në 8 dhe 10 mund të jenë publike, Pjesa 9 do të mbetet konfidenciale për shkak të natyrës së informacionit që përmban.

ZPS-ja po kështu kërkon që të pranohet edhe Shënimi Përgatitor 120550 deri në 158 [Sipas përkthimit] dhe kjo do të mbetet konfidenciale për shkak të informacionit që përmban.

Për sa i përket provave materiale shoqëruese, disa janë të pranuara si prova, kështu që ZPS-ja po kërkon vetëm tre të tilla për pranim, dhe që t'i shtohen deklaratës së Rregullës 152 [Sipas përkthimit]. Janë të paraqitur në Shtojcën 9 të dosjes protokollore 980 [Sipas përkthimit]. Po i lexoj shifrat e tyre.

E para ka shifrën 061274 deri në 61333 [Sipas përkthimit] dhe përkthimet në anglishte. Kjo mund të mbetet publike, provë materiale publike.

E dyta është -- ka shënimin -- ka numrin 1T-03-66 P152 [Sipas përkthimit] dhe 152-A. Edhe komunikata mund të jetë provë materiale publike.

Dhe në fund e treta ka shënimin 1T-03-66 [Sipas përkthimit] P153 dhe 153-A për anglisht -- për gjuhën -- në anglishte. Kjo është kopje e një fotografie që ka sjellë dëshmitari në TPNJ. Edhe kjo mund të paraqitet si provë materiale publike dhe -- dhe kopja me ngjyrë e kësaj prove materiale është pjesë e -- prova materiale e shoqëruese të intervistës me ZPS-në që ndodhet në pjes -- në faqen 0612 [Sipas përkthimit], pjesë e provës materiale 3 që është shënuar në këtë listë provash. Dhe unë siç e thashë, edhe kjo do të duhet të jetë provë materiale publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë kundërshtim nga Mbrojtja e Thaçit?

Z. MISETIC: [Përkthim] Me përjashtim të asaj që kemi thënë për deklaratën e 1154 [Sipas përkthimit] nuk kemi.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo, e njëjta gjë.

Z. ROBERTS: [Përkthim] E njëjta vlen edhe për neve.

Z. ELLIS: [Përkthim] E njëjta vlen edhe për neve.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Intervista e vitit 2005 dhe të pjesës -- e vitit 2019 me përjashtimet e duhura, plus provat materiale shoqëruese dhe Shënimi Përgatitor 1, pra 3 -- të tre provat materiale shoqëruese dhe -- do të pranohen dhe do t'u jepet provë -- numër prove materiale.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

Deklarata numër 1, që ka IT-03-66 351-3630 [Sipas përkthimit] do të ketë provën P114.1 [Sipas përkthimit].

Pjesa e dytë e deklaratës së parë që ka shifrën 0306 [Sipas përkthimit] T3636-T3685 e paredaktuar do të ketë numrin e provës materiale P1114.2.

Dhe pjesa e tretë e deklaratës së parë IT-03-66 T3 gj -- -- 3760 deri në shifrën 3718 do të ketë numrin e provës materiale P114.3 [Sipas përkthimit].

Deklarata e dytë që ka shifrën ERN 083272-TR-AT [Sipas

përkthimit] Pjesa 1 RED do të ketë numrin e provës materiale P115.1 [sipas përkthimit].

Pjesa e dytë e të njëjtës -- me të njëjtën numër prove do të ketë pje -- numrin e provës P1115.2.

Pjesa e tretë do të ketë për numrin e provës 1115.3.

Pjesa e katërt do të ketë numrin P1115.4.

Pjesa e pestë do të ketë numrin e provës P1115.5.

Pjesa e gjashtë do ketë numrin e provës materiale P1115.6.

Pjesa e shtatë do të ketë numrin e provës P1115.7.

Pjesa e tetë do të ketë numrin e provës P1115.8.

Pjesa e nëntë do të ketë numrin e provës materiale P1115.9.

Dhe pjesa dhjetë do të ketë numrin e provës materiale P1115.10.

Për sa i përket provave materiale shoqëruese, e para që ka shifrën 061274-061333 do të ketë numrin e provës P1116.

E dyta provë materiale shoqëruese që ka ERN-në 1T03-66 P152-ET [Sipas përkthimit] e cila -- me variantin në shqipe do të ketë numrin e provës materiale P1117.

Dhe prova materiale shoqëruese e tretë që ka IT-03-66 P153-A me përkthimin në gjuhën shqipe do të ketë numrin e provës materiale P1118.

Për sa i përket Shënimit Përgatitor 1, që ka shifrën 120550 deri në 120558 do të ketë numrin e provës materiale

P1119.

Për sa i përket klasifikimit, të nderuar Gjykatës, siç është -- ka thënë ZPS-ja, ai do të ketë klasifikimin siç e ka treguar pra ZPS-ja.

Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Znj. Prokurore, mund të vazhdoni.

ZNJ D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

Të nderuar Gjykatës, ZPS-ja ka dërguar përmes postës elektronike një përmbledhje sipas rregullës 154, që do të lexohet për këtë dëshmitar, dhe nuk morëm asnjë kundërshtim. Me lejen tuaj, dua ta lexoj për procesverbal dhe për publikun.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet, vazhdoni.

ZNJ D'ASCOLI: [Përkthim] Ramiz Qeriqi është ish-anëtar i UÇK-së i Brigadës 121 të zonës së Pashtrikut. Qeriqi hyri në Kosovë në mars të vitit 1998, bashkë me të tjerë dhe fillimisht shkoi në Likovc me udhëzim të Azem Sylës. Atje u takua me Rexhep Selimin, i cili i dha udhëzime për të organizuar dhe shtrirë njësitet e UÇK-së në zonën e tij. Më pas shkoi në Kleçkë, dhe përfundimisht në Kryemir, në zonën e tij, ku dhe ushtroi funksionet e veta. Ka qenë komandant i Batalionit të dytë të Brigadës 121, një pozitë që u formalizua prej Fatmir Limajt, duke e emëruar me shkrim në mes të gushtit të vitit 1998.

Në fillim të gushtit të vitit 1998 Ramiz Qeriqi u vizitua nga Azem Syla, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Ramë Buja, për shkak të një mosmarrëveshje që kishte Qeriqi me Shukri Bujën.

Ramiz Qeriqi mbeti në këtë pozitë deri në demobilizimin e UÇK-së dhe do të japë dëshmi për strukturën, organizimin dhe veprimtaritë e Batalionit të tij dhe të Brigadës për gjatë luftës.

Kjo ishte përmbledhja, të nderuar Gjykatës. Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull, tani mund të vazhdoni me pyetjet tuaja.

ZNJ D'ASCOLI: [Përkthim] Po.

PY. Dëshmitar, tani që deklarata tuaja të mëparshme janë pranuar në provat gjyqësore, për 25 minutat që na kanë mbetur, mundet t'ju bëj disa pyetje lidhur me disa aspekte të ndryshme, përfshirë -- lidhur me disa nga dokumentet që ju kemi treguar gjatë seancës përgatitore, dhe do të rifillojmë nesër sërish me dëshminë tuaj.

Do të fillojmë me disa pyetje për pranverën e vitit 1998, kur mbërritët në Kosovë nga Shqipëria.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për këtë do kërkoja të shfaqej në ekran materiali me numër ERN U015-8743 deri në U015-9047. Ndërsa në anglisht përfundon me "Revised 1". Fillimisht doja që në ekran të shfaqej ballina.

PY. Dëshmitar, e shihni në shqip, ë? Ë? Ballinin e librit të

Jakup Krasniqit? Pra është "Kthesa e Madhe", "Ushtria Çlirimtare e Kosovës", është në botuar në vitin 2006. A ju kujtohet që ua kemi treguar këtë gjatë seancës përgatitore dhe thatë se nuk e keni lexuar këtë libër? Ju kujtohet?

PË. Po, më kujtohet. Dhe ashtu kam thanë, që s'e kam lexu.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Ju lutem të shkojmë në faqen U0015-8849, në të dyja gjuhët, që është faqja 106 në libër. -- gjuhët.

PY. Z. Qeriqi, kjo është një pjesë ku flitet për nën zonën operative të Pashtrikut. Unë do t'iu lexoj disa pjesë. Presim të dali dhe shqipja në ekran.

PË. Ka dalë. E, u heq qetash. Mirë. Ah --

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] ERN 8849 në të dyja gjuhët. Po, kjo -- na duhet të shohim fundin, ku flitet për zonën e Pashtrikut.

PY. Dëshmitar, unë do lexoj disa pjesë, dhe më pas do t'iu bëj pyetjen. Fillon me territoret që mbulonte komuna në këtë zonë: Prizreni, Sha -- Malishevën -- siç e shikoni.

Unë do të lexoj ku thuhet:

"Në këtë nën-zonë organizimi i Ushtria Çlirimtare të Kosovës është barë -- është bërë në bazë të njësiteve."

Mund ta ndiqni edhe në ekran, por mund të ndiqni edhe përkthimin.

"... dhe më pas u bënë formacione ushtarake. Brigada ishte formacioni më i madh ushtarak."

Më pas vijon, por unë dua të bëj një përmbledhje më vonë. Tani, kjo fjalia që sapo ju lexova unë, a përputhet dhe me dëshminë tuaj --

PË. Edhe një herë --

PY. -- a pra -- çfarë, të përsërisim pyetjen thatë, apo të lexojmë edhe një herë fjalinë?

PË. Jo, vetëm atë fjalinë në -- vetëm fjalinë.

PY. Po. Është kjo: Do ju bëja pyetje për këtë. Thuhet kështu:

"Edhe në këtë nën-zonë, organizimi i Ushtria Çlirimtare të Kosovës është bërë në bazë të njësiteve, për të kaluar më vonë në formacione ushtarake. Brigada ishte formacioni më i madh ushtarak."

Është e qartë kjo që iu lexova?

PË. Te – te ne ashtu ka qenë, ka qenë Brigada, ka qenë. Domethënë, se -- e kam përfaqësu batalionin. Deri sa kam përfaqësu Batalionin, normal që ka qenë Brigada për mue.

PY. Po. Por, më lejoni që t'iu bëj unë pyetje. E ke -- e shënuam komentin tuaj. Ajo që ju lexova unë dhe faktin që organizimi i UÇK-së fillimisht ishte me njësite, të cilat u ba -- më vonë u bënë formacione ushtarake, kjo pjesë a tregon vërtetë organizimin në zonën tuaj të përgjegjësisë së UÇK-së

PË. Po --

PY. -- në prill, maj të vitit 1998?

PË. Po.

PY. Pra që ishte ndarë në njësite?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, dëshmitar, ju lutem pasi të përfundojë pyetja e Prokurorit, bëni pak pushim dhe më pas përgjigjuni. E kuptoj që mund të flisni pak anglisht, por po flisni njëherazi dhe nuk mund të flasim kështu. Mos e bëni këtë.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Në rregull. Thatë "po". Doja të përfundoja pyetjen dhe të thosha për shembull, ju në deklaratën tuaj keni përmendur njësitet e Sokolit fillimisht, por e morëm përgjigjen tuaj -- njësitet e Çelikut, më falni.

Konfirmoni ju që këto njësite më pas u kthyen në formacione ushtarake, si batalione, kompani, brigada, sikurse na thatë?

PË. Po.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Tani do të doja që të kalonim në faqen tjetër, 107 në libër, në të dyja versionet: U015-8850

PY. Dëshmitar, unë do të lexoj fillimin te shqipja, pesë rreshta më poshtë. Ju lutem dëgjoni:

"Kur strukturat e Ushtria Çlirimtare të Kosovës u përfunduan, u bënë -- u krijuan pesë brigada në këtë nën-zonë. Një – njëra poshtë Brigadës 121, që shtrihej nga Llapushniku deri në Duhël, më falni, duke përfshirë të gjithë fshatrat që shtriheshin përreth maleve të Berishës..."

Më pas vijon, dhe përshkruhen brigadat e tjera.

Ju keni dhënë dëshmi se Brigada juaj 121 kishte pesë

[Sipas përkthimit] batalione dhe ju ishit komandant i Batalionit 2? Kështu?

PË. Ju lutem, katër kam thënë, jo pesë. Katër, katër batalione.

PY. Po, po. Katër. Katër batalione, dhe ju keni qenë komandant i Batalionit të 2-të, Ruzhdi Salihu, kështu?

PË. Po.

PY. Për një periudhë kohore, në verë të vitit 1998, Brigada 121 quhej Agim Celaj Colli? Kështu?

PË. Agim Celaj, Coli. Po.

PY. Agim Celaj ka vdekur në luftime. Agim Qelaj ka vdekur në luftime?

PË. Po.

PY. Na -- ju kërkojmë ndjesë për shqiptimin.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë te faqja tjetër, 108 me ERN U015-8851 në të dyja gjuhët.

PY. Dëshmitar, do ju lexoj një pjesë për Ismet Jasharin këtu, që e njihnit që nga ditët tuaja të para në UÇK. Na keni treguar edhe një fotografi me të, që tani është pjesë e provave gjyqësore dhe ka marrë numrin P1118. Po ju lexoj për Ismaet Jasharin:

"Pas fillimit të luftës çlirimtare në Kosovë Ismet Jashari ka qenë një prej të parëve që u largua për në Zvicër, pra la -- la -- la gjirin e ngrohtë të familjes dhe standardin e Zvicrës dhe vjen në barrikadat e luftës për liri. Shpejt u

pa se Ismeti ishte një luftëtar i vendosur dhe guximtar, që posendote aftësi organizative dhe komanduese."

Pastaj flitet për ofensivën e verës së vitit 1998, dhe atje ai ra heroikisht, ballë për ballë me armikun.

"Pas rënies heronike [Sipas përkthimit], me vendim të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Brigada 121 mori emrin Kumanova. Ky ishte emri luftarak i Ismet Jasharit, të cilin e njihnin të gjithë ushtarakët e UÇK-së."

A përputhet kjo edhe me atë që ju kujtohet ju, pra që emri i Brigadës 121 u ndryshua dhe u quajt "Brigada Kumanova" pas vrasjes së Ismet Jasharit?

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Për referencë kjo është e përmendur në intervistën me ZPS-në në Pjesën 1, faqja 12.

PË. Po, kjo është -- është -- e ka ndërru komandanti i Brigadës, Fatmir Limaj. Domethënë, veç kur na ka thanë që është -- quhet "Kumanova". Pa ndonjë farë mbledhje, pa --

PY. Po, në intervistën që i keni dhënë ZPS-së thatë që:

"U ndryshua emri dhe u quajt Kumanova pa na pyetur për këtë."

PË. Po, po.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shikojmë faqen 116 -- 126 të librit, dhe do të diskutojmë zonën e Nerodimës këtu. Numri ERN është U015-88

PY. Dëshmitar, do t'ju lexoj disa rreshta për Shukri Bujën dhe Agim Bajramin. Po e lexoj.

"Shukri Buja e Agim Bajrami, pas shpërthimit të luftimeve në mars të vitit 1998 në Drenicë, me shumë shokë do të lenë mbrapa jetën e rehatshme të botës perëndimore, për t'ju ardhur në ndihmë shokëve të UÇK-së. Me vendim të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së ata u vendosën, prej nga do të përgatiteshin për të bërë organizimin e formacioneve të UÇK-së për nën-zonën e Nerodimës."

Pastaj thotë që pasi morën përvojë në organizimin e Ushtria Çlirimtare të Kosovës në fshatrat si Shala Kryemir, etj --

Ne kemi dëshmi Bujën [Sipas përkthimit] për Shukri Bujën kur erdhi ai në zonën tuaj në Krojmir, në pranverë të vitit 1998, më duket se thatë, se në prill të vitit 1998 -- dhe të gjitha janë në Pjesën 3, faqja 31 të intervistës së ZPS-së dhe në shënimin përgatitor.

Dëshmitar, po Agim Bajramin, e njihnit?

PË. E kam pas njoft më herët, e kam pa në herë në Gjermani e një herë në Kosovë.

PY. Pra me sa e kuptoj e keni takuar në Gjermani, kështu?

PË. Në Gjermani një herë dhe në Kosovë një herë. Në luftë jo.

PY. Në rregull. Po edhe ai ishte një nga personat që u largua nga Gjermani për të shkuar në Kosovë në mënyrë që të kyçej në UÇK?

PË. Po, normal. Vetëm se --

PY. Kishte ndonjë nofkë ai me sa keni ju dijeni?

PË. Zefi. Më duket se Zefi.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër, 127, me ERN U015-8870.

PY. Edhe ju jeni përmendur këtu si një person që keni dhënë një kontribut të madh në komunën e Lipjanit. Do ua lexoj këtë pjesë për procesverbal.

"Pas dislokimit të suksesshëm ..."

Është paragrafi i tretë në faqe ...

"Pas dislokimit të suksesshëm të formacioneve të UÇK-së në këtë -- UÇK-së në këtë zonë kontribuuan shumë Ahmet Qeriqi, Heset Sahiti, Fitim Selimi dhe Ramiz Qeriqi, "Luani", në komunën e Lipjanit e në Shtime. Fehmi Mujota dhe Ruzhdi Salihu në Ferizaj.."

E keni njohur Ahmet Qeriqin, Sahiti -- Heset Sahitin dhe Fitimin Selimin, Dëshmitar?

PË. Po. Ahmetin e kam pas kushëri. Për herë të parë e kam parë në maj të vitit 1998. Ai ka qenë i kyçur atje me Radion "Kosova e Lirë", jo me neve në batalion. Ndërsa Heset Sahiti ka qenë në batalionin e parë, ka qenë një kohë të shkurtër komandant kompanie. Fitim Selimi ka qenë doktor, që ka punuar në ambulantën në Sharrë. Këtu, ky Ruzhdi Salihu që thotë, ka qenë -- ky ka shërbyer te na, në batalion dhe për atë batalioni e ka emrin Ruzhdi Salihu. Për këtë, është ushtari i çarë që është vrarë gjatë betejave.

PY. E kuptoj.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Faqja e fundit që do të doja të shihnim është me numër U0015-8871, faqja 128 e librit.

PY. Dhe këtu diskutohet, përmendet edhe Agim Bajrami. Thotë, kur lufta u përshpejtua -- me eskalimin e Luftës Çlirimtare në pranverën e vitit 1998, ai shkoi në Kosovë dhe përmendet edhe nofka Zefi këtu, që në fakt përputhet me atë që sapo na thatë. Kështu?

PË. Po.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ZPS-ja kërkon që të pranohen këto pjesë të librit që lidhen me zonën e Pashtrikut dhe të Nerodimës dhe faqet përkatëse janë U0015-8849 deri në 8853 për zonën e Pashtrikut. Për zonën e Narodimës U0015 deri në 8869 -- deri në 88 71. Besoj se faqja --

Pra është një pjesë e këtij libri që është pranuar si provë materiale dhe ka numrin P00189, prandaj unë kërkoj që të pranohen deri në faqen 8873, sepse mendoj që nuk janë të përfshira në provat materiale që citova. Kështu që do lutesha që nëse është e mundur, të bashkëngjiten me provat materiale.

Z. ELLIS: [Përkthim] E kundërshtoj sa i takon themelësisë. Dëshmitarit i treguan disa faqe, ka konfirmua disa detaje shumë sipërfaqësore, disa emra që i njohte.

Nuk i kanë treguar pjesën tjetër të librit, dhe madje as të gjithë faqen që kërkohet tani që të pranohet. Prokuroria duhet të japë edhe arsyet pse kërkohet që të pranohet ky

material dhe s'i ka dhënë arsyet.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Shumë nga fragmentet që unë lexova janë konfirmuar me dëshmitarin, përputhen me dëshminë e tij. Unë mund t'i marr rresht për rresht, por nuk ishte nevoja për hir të kohës. Unë mendoj që ajo që konfirmon dëshmitari mjafton si arsye për t'u pranuar në këto materiale.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali që kërkohet të pranohet është i kënaqshëm dhe është në bazë të rregullës 138 dhe do ta pranojmë.

[Trupi Gjykues dhe Sekretari i Seancës këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Meqenëse disa prej këtyre faqeve janë të pranuar paraprakisht, atëherë ne do t'i bashkojmë me atë që janë pranuar por do të doja të shikojmë pak më vonë dhe do të marrim vendimin përkatës.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në fakt edhe unë do -- mendoj që kështu është më mirë që të jenë në një provë të vetme materiale.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kanë ngelur edhe dy minuta. A doni të ndaloni tani, Prokurore?

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në fakt më mirë kështu sepse dokumenti tjetër nuk mbaron për dy minuta.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Doni të thoni që të vazhdoj?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po thatë që

keni edhe dy minuta.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Po ju thosha që kam një dokument tjetër, por do përpiqem ta mbaroj për dy a tre minuta.

Faleminderit.

Ju lutem nxjerrim në ekran dokumentin me ERN U009-1004 [Sipas përkthimit], faqja 5 në anglisht dhe faqja 6 për dokumentin origjinal.

PY. Dëshmitar, sapo folëm për Shukri Bujën. Ndërkohë që të shfaqet dokumenti në ekran, por doja t'iu jap pak kontekst.

Në deklaratat tuaja keni thënë që një prej nofkave të tij gjatë luftës ka qenë Komandant Sokoli, kështu?

PË. Po.

PY. A ju kujtohet që e keni dhënë -- i keni dhënë një dokument ish-Tribunalit të Hagës, që ishte i nënshkruar prej tij?

PË. Po.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Nuk po shoh dokumentin në ekran. Edhe një herë, ERN-ja është U009-0999-U009-1004. Është deklarata që i ka dhënë ish-Tribunalit të Hagës më 28 shkurt të vitit 2005. Ju lutem vendosni pjesën, më falni, faqen 5 dhe 6 përbri njëra-tjetrës në ekran.

Dokumenti që do t'iu tregoj ka qenë një shtojcë e një deklarate që keni dhënë TPNJ-së, ish-Tribunalit të Jugosllavisë.

PY. Dëshmitar, a e njihni dokumentin në ekran?

PË. Po. Ta shpjegoj?

PY. A -- kush është komandant Sokoli, mund të na thoni? Vazhdoni.

PË. Kjo ka qenë një leje udhëtimi që u lëshua nga -- nga Shukri Buja atëherë dhe për lëvizje -- veç shkrun këtu, s'kam nevojë me e spjegu më shumë. Ka qenë udhëtimi me shku në Krojmir-Kleçkë, a dasht me pas leje nga Shukri Buja dhe kjo është një leje e tillë. Është për një person që ka qenë në logjistikë.

PY. Po. A mund të na thoni kush është ky personi --

PË. Ky personi --

PY. -- me -- ky ushtari me emrin Qeli -- Qele?

PË. Ky ushtari me emrin Qeli është Idriz Qeriqi, vëllai im.

PY. Dhe ai ka qenë anëtar i UÇK-së, thatë, ishte në njësitin e logjistikës?

PË. Po.

PY. Përafërsisht, në cilën periudhë, datë, nëse e keni, është shkruar kjo leje?

PË. Kjo mund të jetë diku në prill -- maj. Në maj -- në maj -- maj duhet me qenë.

PY. Ju thatë që këtë dokument ja keni dhënë vetë ish-Tribunalit, kështu?

PË. Po, unë ja kam dhanë se kjo ka mbet në arhiv të batalionit. Në arkiv.

PY. Në rregull, mjafton.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që të pranohet ky dokument. Vetëm faqja 5 dhe 6 e gamës së numrave që lexova për procesverbal dhe mund të jetë i klasifikuar si publik.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni kundërshtime?

Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

Z. ELLIS: [Përkthim] Jo.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali me ERN U09-00 -- 1004 [Sipas përkthimit], faqja 5 dhe 6 pranohen dhe marrin numrin përkatës të provës materiale.

SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Marrin numrin e provës materiale P1120 dhe klasifikohen si publike.

ZNJ. D'ASCOLI: [Përkthim] Në rregull. Unë kaq kisha për sot.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, për sot përfunduam. Nuk qëndruat shumë gjatë me ne sot, por na u desh të përfundonim dëshmitarin që kishim paradite.

Do të rifillojmë nesër në orën 09.00. mos harroni që nuk duhet të diskutoni me askënd për dëshminë tuaj jashtë sallës së gjyqit. Nëse ju kontakton dikush, menjëherë na vendosni në dijeni.

DËSHMITARI: E kuptova.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju urojmë një

mbrëmje të këndshme.

DËSHMITARI: Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nesër në orën 09.00.

--- Seanca mbyllet në orën 16.33